



Nr. 3037 prot.
24.11.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

AMENDAMENT I DEPUTETIT

**TITULLI I AMENDAMENTIT: AMENDIM NË PROJEKTLIGJIN “ PËR NJË SHITESË DHE DISA NDRYSHIME NË
LIGJIN 92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” TË NDRYSHUAR.**

KËRKUES:

Znj. Monika Kryemadhi

Deputet i Kuvendit të Shqipërisë

OBJEKTI:

**“PËR NJË SHITESË DHE DISA NDRYSHIME NË
LIGJIN 92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” TË NDRYSHUAR”.**

BAZA LIGJORE:

Neni 75 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

ARGUMENTIMI I PROPOZIMIT:

Lidhur me këtë projektligj, mendoj se ndryshimet e propozuara nga qeveria shqiptare do të ndikojnë negativisht në mënyrë të pakthyeshme sektorin e bujqësisë dhe agropërpunimin bujqësor. Përpos faktit që qeveria nuk po i mbështet me subvencione fermerët dhe agropërpunuesit, ajo i rëndon më tej ata me taksa të pastudiuara financiarisht.

Kërkoj që neni 3 i projektligjit të cituar në lëndë të mos miratohet.

Të dyja ndryshimet e propozuara në nenin 3 godasin direkt investuesit në fushën e bujqësisë, agropërpunuesit si dhe fermerët.

Më konkretisht, ndryshimi i kërkuar në shkronjën "a" në pikën 38, të nenit 56, për ndryshimin e shifrës së investimit nga 50 milionë në 500 milionë, praktikisht do të bënte të pamundur investimet në bujqësi pasi një shifër e tillë në kushtet aktuale, duke pasur pasur parasysh dhe pasojat e pandemisë do të ishte e pamundur, për 95% të investitorëve shqiptarë.


Sa i takon ndryshimit të shkronjës "c" kjo do të ishte goditja përfundimtare për fermerët shqiptarë, pasi duke shtuar TVSH-në për blerjen e mekanikës dhe pajisjeve bujqësore, praktikisht do të bënin të pamundur blerjen e pajisjeve të reja për fermerët shqiptarë.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, ku specifikohet se: *"Çdo deputet ose Këshilli i Ministrave ka të drejtë të paraqesë në seancë plenare amendamente për projektligjin ose ndryshimet e propozuara nga komisioni përgjegjës, me kusht që ato të jenë të regjistruara paraprakisht në sekretari të paktën 24 orë para fillimit të seancës plenare dhe t'u jenë shpërndarë deputetëve të tjerë"*, paraqes amendamentin sipas Aneksit 1 bashkëlidhur.

Duke e vlerësuar shumë të rëndësishme zhvillimin e bujqësisë, si dhe duke e vlerësuar si thelbësore për ruajtjen e marrëdhënies së besimit midis shtetit dhe qytetarëve, duke përfshirë edhe përgjegjshmërinë e Qeverisë në mbajtjen e premtimeve elektorale, propozoj miratimin e këtij amendamenti në seancë plenare.

MONIKA KRYEMADHI



ANEKSI 3

Në projektligjin PËR NJË SHITESË DHE DISA NDRYSHIME NË
LIGJIN 92/2014, "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË" TË NDRYSHUAR të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

Të shfuqizohet Neni 3.